

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
"CENTER FOR SIGHT "KUKËS" SHPK**

Sot, më datë 14.10.2024 (dymijë e njëzetë e katër), në praninë personale të Ortakëve Themelues të shoqërisë:

1. **Znj. Anu TANEJA**, nënshetase shqiptare, e datëlindjes 05.10.1977, lindur në Indi, banuese në adresën: Kompleksi "Sunrise" Residence, Rruga e Vilave, Lundër, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin me nr. H76005166J.
2. **Znj. Dafina REXHBEÇAJ**, shtetase Kosovare, e bija e Ilhamisë, e datëlindjes 11.9.1973, lindur në Prishtinë, banuese në adresën: Rruga Bajram Thaqi, nr. 16, Prizren 20000, Kosovë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Pasaportën me nr. personal P02029919.
3. **Znj. Valentina KASA**, e bija e Muharremit dhe Fatimes, e datëlindjes 16.09.1982, lindur në Gjon, Mat, banuese në adresën: Saut i Vjetër, Rruga Selim Brahja, Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal I25916057L.

Nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortakët Themelues shprehin vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare "CENTER FOR SIGHT "KUKËS" SHPK, me kushtet si vijon:

**NENI 1
Emri i shoqërisë**

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë "CENTER FOR SIGHT "KUKËS" SHPK, ndërsa emri tregtar do të jetë "INDIAN OPTICAL CENTER "KUKËS".
- 1.2. Ortakët themelues të shoqërisë gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar në kuota.

**NENI 2
Forma e shoqërisë**

- 2.1. Forma e shoqërisë tregtare "CENTER FOR SIGHT "KUKËS" SHPK (në vijim referuar si "Shoqëria") do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 3
Selia e shoqërisë**

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Kukës, në adresën: Rruga Lagja nr. 6; Rruga Sul Elezi; pasuria nr. 34/52-N4, ZK 2315, Volumes 34, fq. 137, Kukës.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**NENI 4
Kohëzgjatja e Shoqërisë**

D. Rexhebi

Anu

V. Kasa

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5 Objekti i veprimtarisë

5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:

- Shërbime okulistike, konsulta oftalmologjike, diagnostikime të patologjive oftalmike, patologjitë korneale dhe glaukoma, patologjitë retinale, neuro-oftalmologjike, shkollitje retine, patologji të oftalmologjisë pediatrike, okuloplastike etj. Ekzaminime dhe trajtime të anomalive rekraktive, korrigjim me syze dhe laser, lente kontakti, injeksione intravitreale, dhe injeksione peri/retrobulbare. Ekzaminime imazherike, biomikroskopia dhe autorefraktometria, topografia korneale, mikroperimetria, tomografia retinale, Eko etj. Ndërhyrje kirurgjikale me anestezi për trajtimin e katarakteve, pterygiumit dhe chulasion ose me anestezi gjenerale për trajtimin e obstrukcioneve të duktusit nazolakrimal.
- Hapje të klinikave oftalmologjike dhe laboreve optike.
- Shërbime të tjera mjekësore, ekzaminime dhe ndërhyrje kirurgjikale. Import - eksport dhe shit-bjerje të të gjitha llojeve të pajisjeve mjekësore dhe elektromjekësore në fushën e mjekësisë. Import – eksport, tregim me shumicë dhe pakicë i artikujve të ndryshëm mjekësor, farmaceutike, medikamente dhe barna të ndryshme mjekësore, materialeve të mjekimit, farmaceutikë, kiteve, reagentëve të ndryshëm, aparateve mjekësore. Hapja dhe ushtrim aktiviteti farmaci dhe depo mjekësore për furnizimin e tyre. Hapja dhe ushtrim i aktivitetit për Laboratore biokimike. Veprimtaria do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Neurologji, Gastroenterologji, Laborator, Kardiologji, ORL, Dermatologji, Endokrinologji, si dhe specialitete të tjera.
- Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali i shoqërisë është në vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Euro, i ndarë në 3 (tre) kuota.
- 6.2. Ortakët themelues zotërojnë përkatësisht nga 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, konkretisht:
- Ortakja Znj. **Anu TANEJA** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 40 % në kapitalin bazë të shoqërisë, në vlerën 20,000 (njëzet mijë) Euro;
 - Ortakja Znj. **Dafina REXHBEÇAJ** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 35 % në kapitalin bazë të shoqërisë, në vlerën 17,500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro.
 - Ortakja Znj. **Valentina KASA** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 25 % në kapitalin bazë të shoqërisë, në vlerën 12,500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro.
- 6.3. Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakët themelues në tërësi dhe do të shlyhet prej tyre.

Dafina Rexhbeçaj

Anu

Valentina

NENI 7
Organet Drejtuese

7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8
Administrimi

8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhen për një afat deri nëpesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

8.2. Administratori i Shoqërisë "CENTER FOR SIGHT "KUKES" SHIPK është Znj. **Valentina KASA**, e bija e Muharremit dhe Fatimes, e datëlindjes 16.09.1982, lindur në Gjon, Mat, banuese në adresën: Sauk i Vjetër, Rruga Selim Brahja, Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal I25916057L.

8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 9
Ligji i aplikueshëm

9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe parashikimet e Statutit të nënshkruar nga Ortakët Themelues.

NENI 10
Regjistrimi

10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11
Dispozitat përfundimtare

11.1. Akti Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Znj. Anu TANEJA

ANU TANEJA
Anu
3

Dh. Xh. Xh.

Anu
Anu

Znj. Dafina REXHBEÇAJ

Dafina Golona Keshkeshy

Skutleçy

Znj. Valentina KASA

Valentina Kasa



STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE
"CENTER FOR SIGHT "KUKES" SHPK

Sot, në Tiranë, më datë 14.10.2024 (dymijë e njëzetë e katër), Ortakëthemelues:

1. Znj. Anu TANEJA, nënshetase shqiptare, e datëlindjes 05.10.1977, lindur në Indi, banuese në adresën: Kompleksi "Sunrise" Residence, Rruga e Vilave, Lundër, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin me nr. H76005166J.
2. Znj. Dafina REXHBEÇAJ, shtetase Kosovare, e bija e Ilhamisë, e datëlindjes 11.9.1973, lindur në Prishtinë, banuese në adresën: Rruga Bajram Thaqi, nr. 16, Prizren 20000, Kosovë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Pasaportën me nr. personal P02029919.
3. Znj. Valentina KASA, e bija e Muharremit dhe Fatimes, e datëlindjes 16.09.1982, lindur në Gjon, Mat, banuese në adresën: Sauk i Vjetër, Rruga Selim Brahja, Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal I25916057L.

Të cilët kanë themeluar shoqërinë "CENTER FOR SIGHT "KUKES" SHPK dhe kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), si dhe dispozitat e tjera të legjisllacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, si vijon:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Emri i shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë "CENTER FOR SIGHT "KUKES" SHPK, ndërsa emri tregtar do të jetë "INDIAN OPTICAL CENTER "KUKES"".
- 1.2. Ortakët themelues të shoqërisë gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar në kuota.

NENI 2

Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë tregtare "CENTER FOR SIGHT "KUKES" SHPK (në vazhdim referuar si "Shoqëria") do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 3

Selia e shoqërisë

Dedelej

Anu
V.K.

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Kruga Lagja nr. 6, Rruga Sul Elezi**
pasuria nr. 34/52-N4, ZK 2315, Volumi 34, fq. 137, Kukës.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4 **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5 **Objekti i veprimtarisë**

- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të :

- Shërbime okulistike, konsulta oftalmologjike, diagnostikime të patologjive oftalmike, patologjitë korneale dhe glaukoma, patologjitë retinale, neurooftalmologjike, shkollitje retine, patologji të oftalmologjisë pediatrike, okuloplastike etj. Ekzaminime dhe trajtime të anomalive rekraktive, korrigjim me syze dhe laser, lente kontakti, injeksione intravitreale, dhe injeksione peri/retrobulbare. Ekzaminime imazherike, biomikroskopia dhe autorefraktometria, topografia korneale, mikroperimetria, tomografia retinale, Eko etj. Ndërhyrje kirurgjikale me anestezi për trajtimin e katarakteve, pterygiumit dhe chalasion ose me anestezi gjenerale për trajtimin e obstrukcioneve të duktusit nazolakrimal.
- Hapje të klinikave oftalmologjike dhe laboreve optike.
- Shërbime të tjera mjekësore, ekzaminime dhe ndërhyrje kirurgjikale. Import - eksport dhe shit-bjerje të të gjitha llojeve të pajisjeve mjekësore dhe elektromjekësore në fushën e mjekësisë. Import – eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë i artikujve të ndryshëm mjekësor, farmaceutike, medikamente dhe barna të ndryshme mjekësore, materialeve të mjekimit, farmaceutikë, kiteve, reagentëve të ndryshëm, aparateve mjekësore. Hapja dhe ushtrim aktiviteti farmaci dhe depo mjekësore për furnizimin e tyre. Hapja dhe ushtrim i aktivitetit për Laboratore biokimike. Veprimtaria do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Neurologji, Gastroenterologji, Laborator, Kardiologji, ORL, Dermatologji, Endokrinologji, si dhe specialitete të tjera.
- Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë.

II. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

NENI 6 **Përgjegjësia e ortakëve**

D. K. K.

Amu

[Signature]

- 6.1.Ortakët e shoqërisë mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

NENI 7

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

- 7.1.Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.
- 7.2.Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjëndjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapë personave të paautorizuar do i shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.
- 7.3.Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, vetëm duke respektuar të drejtën e parablerjes së kuotës nga ortaku tjetër në shoqëri. Heqja dorë nga shoqëria dhe/ose tjetërsimi i kuotës nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruar deri në atë moment.
- 7.4.Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektivit të veprimtarisë së saj të përcaktuar në Nenin 1.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 8

Kapitali i Shoqërisë

- 8.1.Kapitali i shoqërisë është në vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Euro, i ndarë në 3 (tre) kuota.
- 8.2.Ortakët themelues zotërojnë përkatësisht nga 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, konkretisht:
- Ortakja **Znj. Anu TANEJA** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 40 % në kapitalin bazë të shoqërisë, në vlerën 20,000 (njëzet mijë) Euro;
 - Ortakja **Znj. Dafina REXHBEÇAJ** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 35 % në kapitalin bazë të shoqërisë, në vlerën 17,500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro.

D. Rexhbeçaj

Anu

V. Rexhbeçaj

- Ortakja Znj. Valentina KASA zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 25 % në kapitalin bazë të shoqërisë, në vlerën 12,500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro.

8.3. Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakët themelues në tërësi dhe do të shlyhet prej tyre.

NENI 9

Fitimi pronësisë dhe transferimi i kuotave

- 9.1. Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose transferohen nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - shit-blerjes;
 - trashëgimisë;
 - dhurimit;
 - në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
- 9.2. Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, për hyrjen në shoqëri të ortakut të ri është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parblerjes.
- 9.3. Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 10

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 10.1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.
- 10.3. Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.
- 10.4. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

NENI 11

Fondet rezervë

- 11.1. Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.
- 11.2. Ajo disponon lirishit mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 12

Përdorimi i të ardhurave neto

- 12.1. E ardhura neto që rezultojnë nga zbritja e shpenzimit e bëra për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që

Drejtori

[Signature]

rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

NENI 13 **Pasqyrat financiare**

- 13.1. Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në pasqyrat e saj financiare në monedhën vendase ose në monedhë të huaj, sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.
- 13.2. Bilancijetorparaqitet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
- 13.3. Forma e pasqyrave financiare përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 14 **Plani financiar**

- 14.1. Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.
- 14.2. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 15 **Shpërndarja e fitimeve**

- 15.1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
- 15.2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 16 **Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve**

- 16.1. Shoqëria do të shpërndajë fitimet e ortakëve në çdo fund të vitit financiar, pas miratimit të bilancit nga Asambleja e Ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 16.2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme. Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë

Dhimitër Çapari

Amu

Vuk

paguese. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

- 16.3. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjëndjen e aftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjëndje.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 17

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

17.1. Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

17.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve merr vendime për:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
6. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. zmadhimin dhe zvogëllimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
13. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

17.3. Përsa kohë shoqëria ka një Ortak të Vetëm, Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë është Ortaku i vetëm i saj.

NENI 18

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

18.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

D. Kallabegovi
Amu
[Signature]

18.2. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

18.3. Asambleja e përgjithshme thirret detyrimisht nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

18.4. Përsa kohë kuota e vetme e kapitalit themeltar të shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm, kompetencat e mësipërme ushtrohen nga ai.

NENI 19

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

19.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

19.2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

19.3. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 20

Kuorumi i nevojshëm dhe vendimmarrja

20.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 40 për qind të kuotave.

20.2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

20.3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

20.4. Asambleja e përgjithshme vendos me 60 (gjashtëdhjetë) % të votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Drexler

Am



- 20.5.Për çeshtjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 20.6.Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 20.7.Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, kryhet me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
- 20.8.Ortakë, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

NENI 21

Proces-verbali i mbledhjes së asamblesë

- 21.1.Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- 21.2.Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
- 21.3.Proces-verbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 21.4.Proces-verbali i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 21.5.Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 22

Administratorët

- 22.1.Asambleja e përgjithshme emëron një ose deri në tre persona fizik si administratorë të shoqërisë.
- 22.2.Afati i emërimit, nuk mund të jetë me i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje.
- 22.3.Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Administratorit do të përcaktohen në aktin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme.
- 22.4.Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 22.5.Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 22.6.Administratori Shoqërisë "CENTER FOR SIGHT "KUKES" SHPK do të jetë **Znj. Valentina KASA**, e bija e Muharremit dhe Fatimes, e datëlindjes 16.09.1982, lindur në Gjon, Mat, banuese në adresën: Saut i Vjetër, Rruga Selim Brahja, Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal I25916057L.
- 22.7.Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet, si dhe të përfaqësojë shoqërinë përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me pale të treta.

D. Rukleberg

Amir
Vat

- 22.8. Administratori ka të drejtë të delegojë tek një apo disa persona të tjerë kompetencat e tij pa kufizim.
- 22.9. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 23

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

- 23.1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 2. Përfaqesojnë shoqërinë tregtare;
 3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 5. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 7. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 9. Thërrasin asamblesë së përgjithshme kur shoqëria brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.

NENI 24

Shpërblimi i administratorëve

- 24.1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme apo ortakut të vetëm.
- 24.2. Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- 24.3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të

D. R. R. R. R.

Aur

[Signature]

administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 25
Ekspertët Kontabël

- 25.1. Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e ben Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.
- 25.2. Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.
- 25.3. Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që jane gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

VI. MARRËDHENIET E PUNËS

NENI 26
Marrëdhëniet e punës

- 26.1. Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.
- 26.2. Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratave individuale ose kolektive të punës midis Shoqërisë e të punësuarve dhe/ose kontratave të shërbimit.

VII. PRISHJA E SHOQËRISË.

NENI 27
Prishja e shoqërisë

- 27.1. Shoqëria do të priset në rastet kur:
1. merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
 2. hapen procedurat e falimentimit;
 3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në perputhje me piken 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 4. merret një vendim gjykate.
- 27.2. Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratorët, pas përfundimit të procedurave ligjore për likuidimin e saj.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 28
Regjistrimi

Shërbim

Amu
[Signature]

28.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 29

Ligji i aplikueshëm

29.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe parashikimet e Statutit të nënshkruar nga Ortakët Themelues.

NENI 30

Kopje të Statutit

30.1. Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

ANU TANEJA *Anu*
Znj. Anu TANEJA

Znj. Dafina REXHBEÇAJ
Dafina Garona Rexhbeçaj *D. Rexhbeçaj*
Znj. Valentina KASA

Valentina Kasa *V.Kasa*